



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Procesverbali - TAKIMI PUBLIK ME QYTETARË

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Data: 27.12.2023

Ora: 12:00

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës është mbajtur takimi publik me qytetarë, ku të gjithë të interesuarit janë informuar drejtpërsëdrejti nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri dhe Drejtorët e Drejtorive të SHCK-së, në Pejë për të gjitha çështjet nga kompetenca e pushtetit lokal për të cilat preokupohen dhe për të cilat kanë shprehur interesim, siç janë: punët e Komunës së Pejës, prioritetet e Komunës së Pejës, infrastrukturën rrugore, infrastrukturën komunale, shërbimet administrative komunale, buxhetin etj.

Në takim kanë marrë pjesë Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Nënkryetari për Komunitete, z.Mirzet Dzogovic, Drejtorët e Drejtorive, Kryetarët e Bashkësive Lokale dhe qytetarë të Komunës së Pejës.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në takimin publik me qytetarë.

Ky takim organizohet në kuadër të objektivave të komunës për transparencë dhe shërben si njoftim rreth punëve të Komunës, ku qytetarët kanë mundësi t'i japin sugjerimet dhe t'i parashtrojnë kërkesat dhe ankesat e tyre.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri në takimin publik me qytetarë ka raportuar për punët, të cilat kanë përfunduar dhe ato, që janë në përfundim e sipër.

Ky vit ka qenë një vit goxha i vështirë për ekzekutivin, sepse na kanë ardhë rreth 8 milionë gjoba, dënime përmbare kryesisht për shujtat dhe pagat e arsimtarëve edhe mjekëve, prej të cilave janë pagu rreth 6 milionë e 700 mijë, por kanë mbet edhe 1 milion e 200 mijë pa u paguar, por përkundër të gjithave Komuna ka vazhdu me funksionu, por janë mbet disa punë pa u përfundu, por kryesisht kemi punuar.

Këtë vit nga Shërbimet Publike i kemi përfundu procedurat e prokurimit, ku janë rreth 5 mijë metra rrugë në qytet, 36 mijë e 790 metra rrugë në fshatrat e Komunës së Pejës, 38 mijë e 183 metra, ose 38 km rrugë në fshatrat e Rugovës të tenderuara një pjesë e tyre ka përfunduar, janë 9 mijë e 500 metra trotuare, janë punu 6 mijë e 500 metra kanale të hapura, ndërtimi i ujësjellësit Stankaj - Bogë- Shkrel ka mbet duke u punuar rezervari i dytë, janë ndërtuar shtatoret e Gjeneralëve Skender Çeku, Xhemajl Fetahaj, Agim Çelaj dhe Bekim Berisha në parkun e madh në "Karagaq", nga Drejtoria e Urbanizmit kemi arritur t'i dërgojmë për seancën e ardhshme Hartat Zonale, janë ndërtu katër kanale 100-150 metra në "Zatra", "Karagaq"dhe "Kapeshticë", te shkolla ekonomike "Ali Hadri" e kemi punu një kanal, pastaj kanalin e hapur në fshatin Katundi i Ri është ndërpre për shkak të operatorit, në Jabllanicë të Madhe i kemi punu 200 e diçka metra kanal, Drejtoria për Urbanizëm i ka lëshu 294 leje, 12 leje mjedisore, 500 kushte urbanistike, 57 legalizime edhe të hyrat vetanake kanë qenë 554 mijë euro, Drejtoria për Shëndetësi përveç punëve të shumta, të cilat i ka përfundu, janë edhe dy ambulanta të reja në Vitomericë dhe Karagaq, edhe e ka renovuar ambulantën në Bogë, rreth 900 mijë shërbime për qytetarët, pastaj Drejtoria për Zhvillim Ekonomik janë regjistru 523 biznese të reja, janë bërë ndryshime të biznesit 475 dhe 60 biznese janë shu këtë vit, ndërrim certifikate dhe shërbime të tjera janë 630 shërbime të kryera nga kjo drejtori, pastaj Drejtoria për Bujqësi i ka përfundu dy aktivitete të jashtëzakonshme janë rreth 26 km kanale të ujitjes të ndërtuara, pra rreth 1 milionë e 600 mijë euro kanë qenë investime në kanale, penda, si dhe në shërbime të tjera, të cilat janë përfundu, ndërsa te shkollat e kemi pas një vit me shumë punime, janë bërë renovimet e disa shkollave në qytet dhe në fshatra, pastaj Drejtoria për Punë Inspektuese i kanë inspektu 142 objekte, inspektimi final është përfunduar në 7 objekte, 85 kërkesa, të cilat kanë qenë në fazën e inspektimit janë realizu, Shërbimi i Gjendjes Civile ka realizu 130 mijë euro të hyra dhe 118 mijë shërbime për qytetarët, biblioteka "Azem Shkreli" ka pas aktivitete të jashtëzakonshme këtë vit, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizu shumë aktivitete, është në renovim teatri i qytetit, ka pas subvencione për sporte etj., Drejtoria për Mirëqenie

Sociale e kemi ndërtu objektin e ri të drejtorisë, po ashtu kemi duke punuar 12 garsoniere për nënat vetushqyese, Drejtoria për Çështje Pronësoro - Juridike ka punu për bartjen e pronave dhe realizimin e projekteve, që i kemi për hapjen e Lumbardhit dhe projekteve të tjera të shpronësimit, 107 legalizime, 430 kërkesa, prej të cilave vetëm tri nuk i ka realizu, prej 3100 lëndëve janë realizu 2950, prej 300 kërkesave për korrigjim të të dhënave 250 janë përfundu.

Kryesuesi Kurtbogaj e falënderoj Kryetarin Muhaxheri, ndërsa tani, po e hapim debatin dhe do t'ju jap fjalën me radhë qytetarëve, të cilët dëshirojnë të marrin fjalën.

1.Kadri Mavraj – Këshilli Lokal "7 Shtatori", përshëndetje për të gjithë të pranishmit, urime për punën, jam pensioner i ri kam vullnet për t'i përcjellur kërkesat e banorëve në drejtorinë përkatëse, por "7 Shtatori" këtë vit po them janë përfunduar disa punë, por kërkesat, që janë bërë në vitin 2018 në ndriçim për t'u vendos ndriçimi dhe disa punime në rrugën "Naum Veqilharxhi", kanë mbetur, prandaj nuk po e di a me i përsërit kërkesat në vazhdimësi apo me mbet në kujdesin e juaj, që ato me vazhdu? Faleminderit! Ka shumë për të folur, por Ju uroj gjitha të mirat, suksese, keni punuar aq sa keni pas mundësi.

2.Feim Ademaj përfaqësues i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve dhe fillimisht dua të shprehë mirënjohjen tonë për ndonjë ndihmë sado të vogël, që i ke dhënë shoqatës, por edhe të shprehë falënderimin tonë për finalizimin e projektit të ngritjes së lapidarëve të heronjve të kombit në parkun "Karagaq" të Pejës. Sot, jam këtu të shprehë edhe pakënaqësitë e kësaj kategorie për një temë, që ka fillu në vitin 2009, tash e 14 vjet pa finalizim. Kryetar me datë 03.08.2009 Kuvendi Komunal i Pejës ka nxjerr një vendim, që t'ju jap në shfrytëzim nga një parcelë, prej 3 ari të gjithë familjarëve të ngushtë të dëshmorëve dhe janë bërë 14 vjet, që kur Komuna e Pejës, Ju dhuroj nga një parcelë për ndërtimin e shtëpive të banimit të gjitha familjeve të dëshmorëve të Pejës. Kjo dhuratë nëse mund ta quaj kështu mori jehonë s'e gjoja Peja bëri një gjest të mirë për këto familje, që ju dha nga një parcelë prej 3 ari e në fakt nuk ju dha asgjë. Personalisht isha kundër kësaj dhurate s'e familjet e dëshmorëve u nënçmuan me këtë dhuratë të Komunës së Pejës, ndërsa në anën tjetër Komuna ju bënte dhurata milionerëve me banesa, të cilat ishin pronë komunale, që edhe sot i shfrytëzojnë si qiramarrës të patrazuar nga askush e në anën tjetër familjeve të dëshmorëve u dhuronin kodra e therra në tokë të lëvizshme e pa asnjë element minimal të infrastrukturës e në disa raste ato parcela ishin të uzurpuara dhe janë akoma të uzurpuara.

Kryetar, familjet e dëshmorëve nuk kërkuan atëherë as parcela e as prona, por ju dhuruan dhe u mashtruan nga një projekt i vizatuar bukur me shumë ngjyra në letër nga arkitektët, por ishte një projekt vetëm në letër, që përmbante infrastrukturë komplet e brenda projektit kishte edhe çerdhe e parqe, e fusha sporti etj., pas kësaj asnjë familje nuk foli e as nuk protestoj, sepse këto familje nuk janë pa kulm mbi kokë, por këto familje dijnë edhe të ndëshkojnë ashtu siç ndëshkuan. Ndëshkuan në vitin 2013 në shumë mënyra duke mos dal në zgjedhje dhe në votim kundër. Kryetar, Ju mund të thoni pse nuk e realizoj ai apo ky, por vendimet komunale të Asamblesë Komunale ose duhet të vazhdojnë aty ku kanë mbetur ose të revokohen nga organi, i cili i ka miratu, pra në këtë rast nga Kuvendi Komunal. Tani ky vendim i Komunës kërkon një epilog ja të vazhdojë me prioritet ky projekt, ja të nxjerret një vendim i ri, i cili i revokon vendimet. Pyetjet e mia në këtë rast janë në këto dhjetë vjet të qeverisjes suaj a ishte ndonjëherë temë diskutimi kjo lagje dhe këto parcela edhe pse disa herë kemi bërë kërkesa me shkrim dhe janë të protokolluara dhe asnjëherë s'kemi marr përgjigje si shoqatë. Prindërit e dëshmorëve, po vdesin çdo ditë nga mosha, por edhe sa vjet duhet të presin këta prindër, që të gëzojnë këtë dhuratë nënçmuese të vitit 2010? Faleminderit!

3.Mevlyde Idrizi përshëndetje për të gjithë u lexu e u tha shumëçka është shumë e vështirë me mbajt mend edhe për Ju, që punoni edhe për ne si qytetarë. Do të ishte mirë për Komunën me i punu disa lloje të broshurave, që me pas dikush me lexu nëse i intereson për të gjitha punët, të cilat kryhen ose ngecin. Unë i kam tri shqetësime, që besoj janë të të gjithë neve këtu. Shqetësimi i parë, që e kemi ngrit edhe kur isha pjesë e Asamblesë e kemi rregullu atëherë për çmimin e bukës, sepse është e vetmja Komunë, që çmimin e bukës e ka me 60 cent derisa të vetmit furrarë në Pejë janë Mallakt, që bukën bazike e kanë 50 cent, që i bjen nëse ata kanë llogari me shit 50 cent pse mos me shit edhe të tjerët? Në mandatin e parë Kryetar ke arrit me nivelizu çmimin, ndërsa shqetësimi i dytë janë qentë endacak, që janë shqetësim i gjithë Kosovës edhe ka dhjetë vite nga ky shqetësim. Unë e lexova diku, që ka fillu ndërtimi i një strehimoreje, që do t'i ndihmonte shumë qytetarët e Pejës duke qenë se vetë kam qenë e rrezikuar dyherë nga qentë. Kush e bën këtë financim dhe kur pritët të përfundojë ky projekt, besoj, që ndoshta ish dasht me i bo shtytje më shumë s'e të gjitha punëve të tjerave, që qytetarët me kalu lirshëm dhe një problem tjetër si qytetare e Pejës është s'e kemi shumë ankesa nga prindërit për kurset private nuk e kam fjalën për kurse, që përgatiten për fakultet, as ato të gjuhëve të huaja, por e kam fjalën për kurset e ciklit të ulët kur mësimdhënësi

vetë i merr dhe punon me fëmijët e klasës së vetë, që i bjen s'e duhet me qenë sadopak të licencuar, prandaj do të ishte mirë Inspektorati me dal në terren dhe nëse do të gjobiten dy ose tre, por ka edhe prindër, që vetë i dërgojnë, por po pësojnë ata, të cilët i kanë kushtet më të dobëta sepse për një prind mjafton 30 euro në muaj me pas vetëm një fëmijë e lëre më nëse i kanë dy ose tre. Besoj, që të gjitha këto shqetësime me pak mund kishin mujt me u rregullu edhe me qenë një jetë më e lehtë për qytetarët. Faleminderit!

4. Agim Haxhijaj – Kryesues i Këshillit të Bashkësisë Lokale, në fshatin Treboviq së pari viti 2023 për Këshillin Lokal ka qenë më i suksesshmi sesa vitet e kaluara, duhet t'i falënderoj të gjithë akterët, të cilët kanë ndikuar siç janë: Drejtorja e Arsimit, e Bujqësisë, Shërbimeve Publike, Emergjencës etj. Ajo, që dua të them është s'e në vitin, që po vjen i kemi disa detyra, por problemin më të madh e kemi me operatorin, sepse rastin konkret e kam pas rrugën, e cila e lidh Vitomericën me Katundin e Ri, që del në Vitomericë atje kur operatori vjen e zhbllokon vetëm gjysmën e urës, e kemi rastin e Katundit të Ri, që operatori nuk e përfundon kanalën e hapur dhe shumë raste të tjera. Sot, unë nuk do të flasë më shumë, por dua të falënderoj Drejtorin e Arsimit në këtë rast për punën, që e ka bërë në shkollën në fshatin Qyshk për rrethimin e shkollës, ajo që ka mbet ka mbet, pra duhet të mbyllet ana e pasme për arsye, që mos t'i vjedhin drunjtë. Drejtori i Shëndetësisë faleminderit, që more pjesë në takim, sepse e kemi një ambulante, e cila po shkatërrohet në Treboviq, çfarë do të bëni me të? Ju uroj Vitin e Ri dhe për vitin tjetër suksese edhe më të mëdha. Faleminderit shumë!

5. Agim Nikqi - Këshilli Lokal "Rrokaqielli" i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e ka dëgjuar për Kryetarët e Këshillave diçka për ligjin e pagave, ndërsa për rrugë aty te stacioni te "Rrokaqielli" e kam edhe një kërkesë, të cilën e kam dorëzuar te Shërbimet, ndërsa për trotuar dhe drita i kemi disa lojëra të fëmijëve. Kryetar "Rrokaqiellin" me ngjyros a ka mundësi, te rruga "Papa Klemente" janë disa parkingje, janë disa autolarje, të cilat i bllokojnë shumë parkingjet. Juve, Ju dëshiroj suksese veç vazhdo kështu Kryetar mirë e më mirë. Faleminderit prej juve!

6.Nexhat Miroci – Kryesues i Këshillit Lokal “Xhemajl Kada” deshta me potencu diçka edhe një pyetje për Komunën ose për të gjithë? A ka ndonjë strategji për cilësinë e ajrit, sidomos në këtë periudhë të dimrit? Është një shqetësim, i cili na prek të gjithëve. Ju faleminderit!

7.Agron Nikqi – Kryetar i Këshillit Lokal – Rugova 1-Drelaj unë i kam disa shqetësime për regjionin e Rugovës, një kërkesë nga banorët s’e kur do të fillojnë dhëniet e lejeve të ndërtimit brenda zonës së Parkut Nacional? Nxemja në shkollën në Drelaj, e cila është duke shkuar dëm, sepse është me një kapacitet të mirë, e ka një kosto të mirë kisha pas dëshirë me e gjet një vend, që të aktivizohet kudo brenda Komunës së Pejës. Faleminderit shumë për mirëkuptim!

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë dhe theksoi s’e do të shihemi në takimet e radhës, si dhe njëkohësisht ju uroj festat e fundvitit.

Rëndësi të posaçme në këto takime ka pjesëmarrja aktive e qytetarëve me ide dhe sugjerime për avancimin e punëve të institucioneve komunale.

Në këtë takim qytetarët janë informuar për të gjitha çështjet, të cilat ju kanë interesuar.

Pjesëmarrja e qytetarëve në këtë takim dëshmon përcaktimin për Demokraci, ku si parakusht kryesor nënkupton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Ky takim mbahet në përputhje me detyrimet, që dalin nga neni 68, pika 68.1 dhe 68.2 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 91, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Pejës.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 13:15.

Procesmbajtësi:

Ariana Lukaj

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIC OF KOSOVO
 REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN PUBLIK ME QYTETARË

Vendi: Salla e Kuvendit

Data: 27.12.2023

Ora: 12:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	Agim Hoxha	BL. Rugovari. Drelaj	M	[Signature]
2	Kadri Mavriq	BL. "7 Shtatori"	M	[Signature]
3	Muse Gjeq	DKA	M	[Signature]
4	Rexhep Kurtboga	K.K. PEJË	M	[Signature]
5	Mevlud Ibrahim	dytbo u	P	[Signature]
6	AGIM HANAJIJA	K.L. TREBOVIA	M	[Signature]
7	Feim Dakucaj	SHED	M	[Signature]
8	Avni GASHI	Loqja Tërëndakë	M	[Signature]
9	Arif Sylej	Roma	M	[Signature]
10	Besart Berisha	LLAIBJANË	M	[Signature]
11	Granit Jashari	Pejë	M	[Signature]
12	DONETA BERDYNAJ	POD GUR	F	[Signature]
13	Januz Haxheraj	Pejë	M	[Signature]
14	Dielliq Berisha	Pejë	F	[Signature]
15	Kastriot Belegu	Dandami	M	[Signature]
16	FETAH BERLINDI	"DORRA I"	M	[Signature]
17	FAIK ZEKI	K.K. PEJË	M	[Signature]
18	DURID SHALA	PEJË	M	[Signature]
19	Agonis Thaqi	Kligme	M	[Signature]

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------

20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				
48				
49				
50				

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------

51	LUAN RADONIQI	PEV	M	<i>L. Radoniqi</i>
52	BOCMIR MUMVHIA	PEJ	M	<i>B. Mumvhi</i>
53	LUAN PAVATA	PGJ	M	<i>L. Pavata</i>
54	BEJHAKI KRASHIRI	PEJE-KARAGAR		<i>B. Krashiri</i>
55	AGIM NIKRI	Rrokagjelli	M	<i>A. Nikri</i>
56	SHEFQET LAJQI	L. Korrisku	M	<i>S. Lajqi</i>
57				
58				
59				
60				
61				
62				
63				
64				
65				
66				
67				
68				
69				
70				
71				
72				
73				
74				
75				
76				
77				
78				
79				
80				
81				

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------

82				
83				
84				
85				
86				
87				
88				
89				
90				
91				
92				
93				
94				
95				
96				
97				
98				
99				
100				